



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PËRMBARIMIT "BEST 2010"

Nr.187/4.Prot

Data, 23 maj 2019

URDHËR

Lënda: Sekuestro për asetet e debitorit

Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Biznesit

I nderuar Drejtor i Përgjithshëm,

Unë Saimir Hoxha, Përmbaruesi Gjyqësor, pasi studiova dokumentacionin që i përket vendimit nr. 475, dt.26.03.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës,

KONSTATOVA:

Se pranë kësaj zyre përmbarimi është depozituar kërkesa e znj.Merita Domi për zbatimin e masës së sigurisë të vendosur në dispozitivin e vendimit të lartpërmendur me palë e objekt:

-**Palët:** Merita Domi dhe Vladimir Ujkan Ozmaj (dtl. 19.03.1967)

-**Objekti:** Sigurimi i objektit të padisë me sekuestro në pasuritë e z.Ozmaj

Nga shqyrtimi i dokumentacionit del se debitori duhet të përmbushë detyrimin ndaj kreditorit si dhe shlyerjen e tarifave/shpenzimeve përmbarimore/gjyqësore.

Ende sot e kësaj dite debitori (administratori, etj) nuk e ka shlyer këtë detyrim e për rrjedhojë QKB mund të nxjerrë një njoftim/shpallje ku të evidentohet ky detyrim.

Për sa më sipër bazuar në nenet 519 e në vijim të K.Pr.C e në nenin 46 i ligjit nr.10031, dt.11.12.08 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor" i ndryshuar,

JU KËRKOJ QË:

1- Të mbani nën sekuestro aksionet/asetet që i takojnë debitorit në çdo lloj aktiviteti për të cilin ju keni informacion;

2- Të informoni me shpallje ose me punonjësit tuaj, debitorin për këtë detyrim;

3- Të më informoni për veprimet tuaja rreth kësaj kërkesë brenda afateve ligjore.

- Bashkëlidhur ju lutem gjeni një kopje të titullit ekzekutiv.

**PËRMBARUESI GJYQËSOR
SAIMIR T. HOXHA**



Zyra e Përmbarimit "BEST 2010"

SAIMIR HOXHA PF (NUIIS L02212504F)

Adresa: prapa Prokurorisë Rrethit Durrës

Tel/Fax: 052- 22 6000; Cel: 069 20 756 44

E-mail: BEST.2010@PERMBARUES.AL



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L71921506A	
2. Data e Regjistrimit	21/07/2017	
3. Emri i Subjektit	BSBAL	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	18/07/2017	
6. Kohëzgjatja	Nga: 18/07/2017	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Durres Durres DURRES Rruga Skenderbej,fraksion 4,ka II-te,nr pronesia 135736,zone kadastrale 3514,volum 38,f 121,nr pasurie 4/208-N 9	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	Dizenjo, Arredim, Hotele, Restorante, stilim, konfeksi etj. Rikonstruksion, dizenjim, arredim, dhe punime objekte te ndryshme, hotele, restorante etj. Shitje, dhenie qira te objekteve te ndryshme. Import eksport, shitje shumice dhe pakice te konfeksioneve te ndryshme si mallrave ushqimore e industriale. Agjensi per sherb turistike. Agjensi udhetimi e transporti udhetaresh, malli brenda dhe jashte vendit. Agjensi sherbimi per transpo ajror, detar e tokesor per pasagjere, nxenes e studente. Sh biletat avioni, autobuzi, trageti etj per brenda dhe ja vendit. Siguracione jete per udhetaret qe udhetojne ne rr tokesore, ajrore, detare. Organizime grupe turis udhetaresh, nxenesish e studentesh brenda dhe jashte ver Tregtim me shumice dhe pakice, import-eksport te malli ushqimore dhe industriale. Ofrimi i sherbimit te dhenie makinave me qera etj.	
10. Administratori/ët	Vladimir Ozmaj	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 18/07/2017	Deri: 18/07/2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	VladimirOzmaj	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Fier Fier FIER Qendra Tregtare VIVA, kati i dyte, dyqan Nr.10. Durres Durres DURRES Lagjja nr. 4, Rruga Skenderbej, Zona Kadastrale nr. 8514, Nr. pasurie 4/33-N Durres Durres DURRES Rr. Skëndërbej, hyrja 1, Zonë Kadastrale 8514 me nr.. pasurie 4/33 N 5, Volumi 34, faqe 31.	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: BSBAL E-Mail: bsbalozmaj@gmail.com Telefon: 0692821759	
15. Statusi:	Aktiv	

Datë: 20/05/2019

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E
SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	K62709809W	
2. Data e Regjistrimit	09/03/2006	
3. Emri i Subjektit	"GYLHANE-2005"	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	27/02/2006	
6. Kohëzgjatja	Nga: 27/02/2006	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Kavaje KAVAJE Lagjja nr.2, rruga Egnatja nderte 8 kate, kati i I-re, zona kadastrale 8551.	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00	
9. Objekti i aktivitetit	Import eksport dhe punimeve tekstile me mall te porosi punime dhe prodhime mermeri, nyje betoni dhe prodh inertestesh e lende ndertimi, import eksport te makineri tekstile, dhe atyre te punimeve te mermerit, transporti makina asfaltimi, makineri e paisje per nyje bet industriale, paisje elektro-shtepiake, konfeksione, kancel ushqimore, pije te ndryshme, artistike etj.	
10. Administratori/ët	Vladimir Ozmaj	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 09/03/2012	Deri: 09/03/2017
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	VladimirOzmaj	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	100,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)	
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Tirane TIRANE MYSLYM SHYRI-L.21 DHJETORI Tirane Kavaje KAVAJE LAGJA 5
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: "GYLHANE-2005"
15. Statusi:	Pezulluar

Datë: 20/05/2019

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Nr i Regjistrimit (21283-03400) 2460/188

Datë regjistrimi 14.11.2018

Nr. i Vendimit (11-2019-1719) 475

Datë vendimi 26.03.2019

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e përbërë nga

VLADIMIR SKËNDERI- GJYQTAR

asistuar nga sekretare e seancës gjyqësore Elona Musai, sot me datë 26.03.2019, mori në shqyrtim çështjen civile me:

PADITËSE

Merita Domi, e bija e Mehdiut, dhe e Xhemailes e datëlindjes 18.07.1978, lindur në Shijak dhe banuese në Durrës Lagja nr.4, Rruga “Iljaz Reka” pallati ‘vapor’ me arsim të lartë, përfaqësuar nga av. Klaudia Kotri me licensë nr 6479 dhe NIPT L51308511U, sipas prokurës së datës 10.07.2018.

I PADITUR

Vladimir Ozmaj i biri i Ujkanit i datëlindjes 18.07.1978, lindur dhe banues në Durrës lagja nr 4 rruga “Iljaz Reka” pallati sipër lokal “Grand” kati i dytë, përfaqësuar në gjykim nga Av. Faslli Çekaj me licencë nr 4145 dhe NIPT L121305021 i pajisur me prokurën nr. 347/286 datë 11.02.2019.

OBJEKTI

Kërkohet lëshimi i urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv deklaratë noteriale Nr.Kol 1723 dhe Nr.Rep 3287 data 10.10.2017, duke urdhëruar ekzekutimin e detyrueshëm të saj për detyrimin e debitorit Z.Vladimir Ozmaj ti kthejë kreditorit Znj Merita Domi automjetin Tip Mercedes Benz

212 B 220 CDI (të dhënat sipas deklaratës noteriale), dhe në pamundësi të kthimit të sendit, kthimin e vlerës tregtare të sendit.

BAZA LIGJORE Nenet 510/d, 511 dhe 512 të Kodit të Procedurës Civile, ligji nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara nga detyrimet kontraktore dhe tregtare", nenet 1,4,5 pika 1,11,16.....Ligjit Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Në përfundim të gjykimit Gjykata dëgjoi paditësin që kërkoj pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit, dëgjoi të paditurin që kërkoj rrëzimin e kërkesëpadisë sa i takon shumës së detyrimit. Pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, Gjykata

VËREN

Përpara Gjykatës është paraqitur kërkesëpadia me palët dhe objektin e pasqyruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Gjykata kryesisht shqyrtoi juridiksionin dhe kompetencën dhe konstatoi se çështja i përket juridiksionit gjyqësor dhe se kjo gjykatë është kompetente të shqyrtojë këtë mosmarrëveshje juridiko civile, qoftë sa i përket kompetencës tokësore, qoftë sa i përket kompetencës lëndore.

Fillimisht, Merita Domi i iste drejtuar Gjykatës me kërkesë për lëshimin e urdhërt të ekzekutimit për deklaratën noteriale nr.1723/3287, datë 10.10.2017. Gjykata vlerësoi se kërkesa duhej rrëzuar sepse në këtë rast, pavarësisht nga emërtimi "deklaratë noteriale" që i ka vënë noteri dokumentit të përpiluar prej tij, në vlerësimin e Gjykatës ndodheshim para një kontrate shitblerje me kusht. Për rrjedhojë Gjykata vlerësoi të domosdoshme që të paraqitej kërkesëpadi themeli me qëllim që gjykata të dëgjonte të dy palët dhe të sqaronte: nëse është paguar ndonjë kësht tjetër përveç kështit të parë në shumën 2500 euro; nëse automjeti posedohet nga blerësi Vladimir Ozmaj apo ja ka kthyer shitëses Merita Domi, etj. Për këtë shkak me vendimin nr(11-2018-5775)801 datë 13.11.2018 Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës.

Më pas paditësja ju drejtuar Gjykatës me këtë kërkesëpadi gjykimin i së cilës përfundoi sot.

Nga gjykimi rezultuan të provuara faktet e mëposhtme:

Me aktin noterial nr. 3287/1723 datë 10.10.2017, paditësja Merita i ka shtur të paditurit Vladimir një autoveturë tip benz me targa AA678RE në shumën, 20.000 euro nga të cilat 2500 euro janë dorzuar në momentin e nënshkrimit të këtij akti noterial, ndërsa diferenca 17.500 euro do të likuidohej me këste benda datës 09.10.2018. Në momentin që do të likuidohej kësti i fundit do të lidhej kontrata noteriale e shitblerjes me qëllim kalimin e pronësisë së mjetit.

Në përputhje me përcaktimet e bëra në aktin noterial nr. 3287/1723 datë 10.10.2017, i padituri Vladimir, po në datën 10.10.2017 ka fituar posedimin e automjetit autoveturë tip benz me targa AA678RE. Po në këtë akt noterial marrësi i mjetit ka deklaruar se "...do të mbaj çdo përgjegjësi si nga ana ligjore ashtu edhe nga ana teknike që vjen si rrjedhojë e përdorimit të mjetit, duke marrë përsipër të paguaj çdo riparim për çdo problem/ difekt që mund ti ndodhë mjetit ndërkohë që unë e kam në përdorim. Palët deklarojnë se nëse kontrata e shitblerjes nuk nënshkruhet brenda afatit të përcaktuar për arsye të moskryerjes së pagesës nga ana e Z. Vladimir Ozmaj, ky i fundit detyrohet të kthejë mjetin dhe humb vlerën e paguar."

Ka rezultuar se i padituri ka rezultuar gjithsej shumën 6500 euro dhe nuk ka likuiduar shumën e mbetur 13500 euro.

Pasi ka mbaruar afati i pagimit të vlerës së automjetit, që ishte data 09.10.2018, paditësja i ka nisur të paditurit kujtesën noteriale nr 4277/2184 datë 12.10.2018 me të cilën e vë në vonesë debitorin dhe e paralajmëron se nëse nuk paguan shumën e mbetur ajo do ti drejtohej Gjykatës.

Në përgjigje të kujtesës noteriale të mësipërme, të datës 20.10.2018 i padituri Vladimir e përfaqësuesi i tij, i kanë shpjeguar paditësës se kanë qenë në vështirësi reale sepse automjeti objekt gjykimi është dëmtuar në autostradën Durrës –Tiranë, në vendin e quajtur Tregu i Madh, për shkak të përmytjes ku automjetin e mbuloi uji. Në vijim të përgjigjes, ***i padituri ka marrë përsipër, likuidimin e shumës së mbetur brenda katër muajve pra brenda datës 20.02.2019.*** Ky likuidim në fakt nuk u krye as në datën 20.02.2019 e as sot më datë 26.03.2019 që po shpallet ky vendim.

Për shkakun e mësipërm paditësja i është drejtuar Gjykatës me këtë kërkesëpadi gjykimi i të cilës përfundoi sot.

Me kërkesë të palës paditëse Gjykata caktoi një eksperte kontabël, e cila në aktin e ekspertimit datë 05.02.2019, përcaktoi se interesi bankar i shumës 13500 euro, i maturuar deri në datën 10.01.2019 është 145 euro dhe interesi ditor është 1,624 euro.

Në seancën e datës 13.02.2019 i padituri nëpërmjet përfaqësuesit të tij pretendoi se, për llogari të shlyerjes së detyrimit që ka ndaj paditëses ka derdhur në western union katër këste me vlerë 1025 euro secili pra 4100 euro. Për të provuar këtë, i padituri paraqiti mandat arkëtimet përkatëse të lëshuara nga western union. Në seancën pasuese paditësja deklaroi se ishte paraqitur në western union për të tërhequr shumën 4100 euro, por ka rezultuar se shuma i ishte kthyer përsëri depozituesit Vladimir Ozmaj. Një fakt i tillë nuk u kundërshtua nga përfaqësuesi i të paditurit. Madje edhe në mandatet e lëshuara nga western union, është shënuar data e kadencës 19.02.2019, që do të thotë se nëse shumat nuk tërhiqeshin nga paditësja deri në datën 19.02.2019 ato kalonin përsëri për llogari të depozituesit. Pra u provua plotësisht se shuma 4100 euro është tërhequr përsëri nga Vladimir Ozmaj.

Bazuar në sa më sipër Gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar në prova e në ligj e si e tillë duhet pranuar. Edhe pse në objektin e kërkesëpadi së saj, kërkimet ishin alternative, pra ose kthimi i shumës ose kthimi i automjetit, në konkluzionet përfundimtare, paditësja kërkoi vetëm kthimin e shumës 13500 euro.

Në vijim të gjykimit paditësja kërkoi edhe sigurimin e objektit të kërkesëpadi duke vënë sekuestro, me arsyetimin se i padituri mund të kërkojë ti shmanget detyrimit. Edhe ky kërkim është i ligjshëm e do të pranohet nga Gjykata.

Për të gjitha shkaqet e mësipërme kërkesëpadia do të pranohet në tërësinë e saj dhe në zbatim të nenit 106 të K.Pr.C. pala e paditur do të ngarkohet me shpenzimet gjyqësore.

Për këto arsye

bazuar në nenin 310, e vijues të K.Pr.C. Gjykata,

VENDOSI

- Të pranojë kërkesëpadinë e paditëses Merita Domi me të paditur Vladimir Ozmaj me objektin e shënuar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.
- Të sigurojë objektin e kërkesëpadisë duke vënë sekuestro në shumën 13.500 euro mbi depozita bankare ose pasuri të luajtshme e të pa luajtshme të të paditurit Vladimir Ozmaj.
- Të detyrojë të paditurin Vladimir Ozmaj që ti paguajë paditëses Merita Domi shumën 13.500 (trembëdhjetëmijë e pesëqind) euro.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Durrës brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.
- U shpall në Durrës, sot datë 26.03.2019.

SEKRETARE
ELONA MUSAI



GJYQTARI
VLADIMIR SKENDERI



Shpenzimet gjyqësore	
Taksa gjyqësore	3000 lekë
Njoftime	300 lekë
Shpenzime Avokati	48000 lekë
Akt Ekspertimi	48000 lekë
Totali	99300 lekë

E NJËNTË ME
ORIGINALIN DT: 23.5.20
PGJ. SAMIR Hoxha

